


Neuromyelitis optica

Neuromyelitis optica spektër i çregullimeve (NMOSD ang. Neuromyelitis optica spectrum of disorders)



Neuromyelitis optica spektër i çregullimeve paraqet një sëmundje të rallë, kronike dhe të rëndë autoimmune të sistemit nervor qëndror e cila fillimisht e dëmton nervin/at optik, palcën kurizore dhe trurin, duke shkaktuar verbim, dobësi muskulore dhe paralizë.

Kjo sëmundje paraqitet 9 herë më shpesh tek gratë se sa tek burat. Më së shpeshi paraqitet tek personat në moshën prej 30 deri në 40 vjet, por mund të dijagnostifikohet edhe në moshën e mesme si dhe tek persona më të moshuar (mbi 50 vjet), e gjithashtu edhe tek fëmijët. Prevalenca e NMOSD ndryshon nga 0,5-10 në 100.000 persona, përsëmbull në Europë kjo sëmundje afekton më shumë se 10.000 persona, në SHBA 15.000 persona e qindra mijë njerëz të tjerë nëpër botë. Tek ne, për shkak të mungesës të regjistrimit të pacientëve, trendi i paraqitjes së rasteve të reja është i panjofshëm, por besohet që në Maqedoni ka rreth 20 pacienta me këtë lloj sëmundje.

Para se të zbulohen kriteret specifike për dijagnostifikim, pacientet shpesh herë kanë qenë gabimisht të dijagnostifikuar, gjë që ka kontribuar drejt mjekimit të gabueshëm dhe progredimit të invaliditetit.

Njerëzit me NMOSD përjetojnë relapse të rënda dhe të paparashikueshme të cilat drejtperdrejt shkaktojnë dëmtim neurologjik kumulativ, të përhershëm dhe invaliditet. Në disa raste, relapsi mund të rezultojë dhe me vdekje. Më së shpeshti simptomat janë verbim, invaliditet, dhimbje, ndjenjë lodhsie dhe inkontinencë, të cilat kontribuojnë drejt zvogëlimit të kualitetit jetësor të pacientëve. Si rezultat i relapseve të shpeshta dhe serioze, shumica e pacientëve përjetojnë

invaliditet të përhershëm, përshebull për 5 vite, 50% të pacientëve me NMOSD do të kenë nevojë për karrocë për invalidë, kurse 62% të pacientëve do të jenë të verbër.

Arsyeja e saktë për paraqitjen e kësaj sëmundje është ende e panjohur, por besohet që interleukin 6 luan rol kyq në patogjenezën e sëmundjes. Nivelet të interleukin 6 janë dukshëm më të larta tek pacientët me sëmundje aktive, në krahasim me pacientët me sklerozë multiple dhe sëmundje të tjera neurologjike jo-inflamtoare. Interleukin 6 është protein në trupin tonë i përbërë nga shumë qeliza imunologjike dhe ka për detyrë të jep sinjal i cili do ta indukojë kaskadën inflamtoare, duke shkaktuar dëmtim neurologjik dhe invaliditet. Përveq kësaj, interleukin 6 e zmadhon permeabilitetin e barierës hemato-encefalike dhe lejon depërtimin e antitropave akvapurin 4 dhe qelizat pro-inflamtoare në sistemin nervor qëndror.

NMOSD më së shpeshti është e asocuar me praninë e auto-antitropave patologjik, të ashtuquajtur akvapurin 4, të cilët dëmtojnë një set specifik të qelizave të quajtura astrocite duke rezultuar me paraqitjen e lezioneve inflamtoare të nervit ose nervave optik/e, palcës kurizore dhe turit. Antitropat akvapurin 4 zbulohen në serum të gjakut tek përafërsisht dy të tretat e pacientëve, dhe paraqet kriterium specifik për dijagnostifikimin e NMOSD

Edhe pse shumica e rasteve të NMOSD mund të jenë të vërtetuara nëpërmjet testeve për dijagnostifikim, njerëzit që jetojnë me këtë gjendje shpesh herë janë gabimisht të dijagnostifikuar me sklerozë multiple. Kjo dukuri paraqitet si rezultat i ngjashmërisë së madhe të karakteristikave klinike tek të dy sëmundjet, duke përfshirë edhe faktin e prevalencës më të madhe tek gratë, simptome të ngjashme dhe fakti që të dy gjendjet janë të karakterizuara me paraqitjen e relapseve.

Praktika momentale në tretmanin e NMOSD përfshin përdorimin e ilaçeve imunosupresive me qëllim që të prevenohet paraqitja e relapseve, mirëpo ky tretman nuk është i mjaftueshëm. Të dhënat e fundit të hulumtimeve klinike janë mjaft premtuese dhe inkurajuese, pasi që ilaçet ereja në kontinuitet tregojnë efikasitet në parandalimin e relapseve dhe pritjet që ta zvogëlojnë dhe ratën e mortalitetit.

Mundësia për testim rutinor të antitropave akvapurin 4, ndjekja e udhëzimeve bashkëkohore për dijagnostifikim dhe tretman me ilaçe të reja për këtë sëmundje të rëndë neurologjike do të kontribuojnë për avancimin e mbrojtjes shëndetsore të pacientëve me NMOSD dhe përmirsim të kualitetit të tyre jetësor.

SANOFI GENZYME 



B:OMARIN



M E D I S

